



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 12,14 dhe 17 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 e datës 4 qershor 2008, neneve 9 shkronja c), 17 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dt.26.09.2008, nenit 6 të Kontratës 1-464-3593 të datës 11.08.2011 për dhënie me qira të lokalit-palujtshmërisë, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 31. 05. 2018, pas shqyrtimit të propozimit të kryetarit miratoi këtë:

VENDIM
PËR SHKËPUTJEN E KONTRATËS 1-464-3593 TË DATËS 11.08.2011 PËR
DHËNIEN ME QIRA TË LOKALIT-PALUAJTSHMËRISË

Neni 1

Me këtë Vendim SHKËPUTET Kontrata 1-464-3593 të datës 11.08.2011 për dhënie me qira me kohëzgjatje prej 8 vitesh të lokalit me sipërfaqe prej 12m² që gjendet në kuadër të objektit të Veterinarisë dhe sipërfaqes tokësore prej 360m² nga parcela kadastrale komunale P-71409044-01311-1 zona kadastrale Lipjan, personit Kadri Krasniqi nga fsh.Konjuh.

Neni 2

Shkëputja e Kontratës siq përcaktohet në nenin 1 të këtij Vendimi bëhet sepse qiramarrësi Kadri Krasniqi nga fsh.Konjuh nuk i ka përmbushur obligimet e tij sipas dispozitave të saj, përkatësisht nuk ka bërë asnjëherë pagesën e qirasë dhe në bazë të mbikëqyrjes së kohë pas kohshme është konstatuar se qiramarrësi e mbanë të mbyllur lokalit ndërsa në pjesën e sipërfaqes prej 360m² ka ndërtuar një objekt montazhë prej llmarine e cila po ashtu është e mbyllur dhe nuk funksionon në të cilën ka publikuar Njoftimin për dhënie me qira të objektit, veprim që është në kundërshtim me nenin 5 të Kontratës.

Neni 3

Obligohet personi-qiramarrësi Kadri Krasniqi që në afat prej 15 ditësh kalendarike nga dita e pranimit të këtij vendimi pas hyrjes në fuqi të liron lokalit dhe të largon-heqë objektin montazhë duke kthyer gjendjen e mëparshme, në të kundërtën komuna do të bën kthimin e gjendjes së mëparshme dhe të gjitha shpenzimet e bëra bien në ish qiramarrësin.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori pronëso- juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati i Prokurimit dhe Drejtorati për Inspekcion.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

15Nr. 463-34524

Lipjani, më 04. 06. 2018

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi

